



Pranuar / Dorëzuar Priljena/Prudato Received/Delivery	02.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ./Jednica Org./Unit	SIK/SHCK	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix
	11/21/2022		Sasia Kolicina Quantity
			115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.50/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.50/2022 të datës 24.01.2022 të parashtruar nga ankuesi

në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Shërbimi Sprovues i Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.50/2022 e datës 24.01.2022 e parashtruar nga ankues
- II. Mbetet në fuqi njoftimi për kandidatin e suksesshëm me Nr.ref.Rn00007888,nr.prot.02 i datës 10/01/22.

### A r s y e t i m

Shërbimi Sprovues i Kosovës, më datë 22.11.2021 ka njoftuar që nga data 07.12.2021 deri më datë 14.12.2021 do të lejohet aplikimin për ngritje në detyrë për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për Personat të Mitur, ku ka aplikuar edhe ankuesja, i cili nga Njësia e Burimeve Njerëzore në bazë të vlerësimit paraprak të aplikacioneve është përfshirë në listën e shkurtër, dhe është ftuar të merr pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas vlerësimit të testit me shkrim, intervistës me gojë dhe jetëshkrimit, në bazë të renditjes përfundimtare të kandidatëve ka marr gjithsejtë 74 pikë, ku përmes sistemit Sistemi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore-SIMBNJ të gjithë kandidatët janë të njoftuar për rezultatin.





Pas përfundimit të procesin dhe publikimit të renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi me pretendimet që ka pasur shkelje procedurale dhe kundër njoftimit për rezultatin përfundimtar, më datë 10.01.2022 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Vlerësimi në kuadër të Shërbimit Sporvues të Kosovës.

Komisioni i Vlerësimit në Shërbimin Sporvues të Kosovës, më datë 13.01.2022 i është përgjigjur ankuesit në ankesën e tij duke e refuzuar si të pabazë dhe të pa argumentuar.

Ankuesi kundër Përgjigjes në ankesë me Nr. 04 të datës 13.01.2022, fizikisht më datë 24.01.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:295/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.01.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Sporvues të Kosovës. Me datë 07.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Sporvues i Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ndërsa më datë 09.02.2022 kemi kërkuar prova shtesë të cilat janë dërguar të njëjtën ditë.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me Nr.Prot:295/2022 të datës 24.01.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Ankesën e ankuesit e datës 10.01.2022 nga ankuesi për Komisionin Vlerësues; Përgjigjen në ankesë e datës 13.01.2022; Konkursin për ngritje në detyrë për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për Personat të Mitur; Emailin e datës 21.01.2022 nga B.Uka për ankuesin; Emailin e datës 21.01.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 21.01.2022 nga . Emailin e datës 21.01.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 20.01.2022 nga ankuesi për . Emailin e datës 11.01.202 nga ankuesi për . Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.01.2022 dhe 09.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 07.02.2022 dhe 09.02.2022; Njoftimin nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Shërbimit Sporvues të Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për përfundimin e procedurave të ngritjen në detyrë e datës 20.01.2022; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 10.01.2022; Emailin e datës 05.01.2022 dhe 28.12.2021 nga për ankuesin për intervistë me gojë dhe testin me shkrim; Njoftimin e datës 24.12.2021 nga Divizioni i Burimeve Njerëzore për kandidatët për listë të shkurtër; Njoftimin e datës 15.12.2021; Listën e aplikantëve nga SIMBNJ; Formularin për vlerësimin e verifikimit paraprak; Vendimin e datës 21.12.2021 për emërimin e komisionit vlerësues; Aplikacionin e ankuesit se bashku me dëshmitë e përgatitjes profesional, përvojës së punës, dëshmitë e vlerësimit të rezultateve në punë dhe dëshmitë e trajnimeve; Aplikacionin e kandidatit se bashku me dëshmitë e përgatitjes profesional, përvojës së punës, dëshmitë e vlerësimit të rezultateve në punë dhe dëshmitë e trajnimeve; Emailin e datës 09.02.2022 për dhe Emailin e datës 09.02.2022 nga plotësimin e ankesës e datës 15.02.2022 nga ankuesi.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale sepse tek jetëshkrimin jam vlerësuar me 15 pikë është dashur 20; Testi me shkrim ka pasur pyetje për të hutuar në përgjigje për të më ve në lajthitje me gabime teknike; Komisioni vlerësues ka ndërhyrë në poentimin tim dhe kandidati i pranuar para 7-8 vitesh ka pasur një incident shëndetësor në vendin e punës.

Bazuar në shkresat e lëndës, në konkursin për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për Perona të Mitur, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: *"Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në shkencat sociale (Sociologji, Psikologji, Punë Sociale) me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Përvoja e punës e kërkuar: së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale"*, ndërsa dokumentet që duhet të paraqitur për aplikim janë: *"Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; kopjet e dëshmisë së punësimit; kopjet e dëshmisë së trajnimeve; kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit; dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende"*.

Në bazë të dokumentacionit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se sipas aplikacionit të ankuesit dhe kandidatit të rekomanduar, të dy kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, duke poseduar dëshmitë e përgatitjes profesionale, dëshmitë e përvojës së punës, dhe dëshmitë që nuk kanë masa disiplinore të pashuara, në këtë rast edhe verifikimi paraprak që këta kandidatë kanë plotësuar kushtet e konkursit është vlerësim i drejtë, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Sprovues të Kosovës ka vepruar në pajtim me nenin 57 ndërlidhur me nenin 45 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale sepse tek jetëshkrimin jam vlerësuar me 15 pikë është dashur 20, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të nenit nenin 61 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri njëzet (20) pikë, ndërsa Komisioni i Vlerësimit në bazë të dokumentacioneve ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidatët ku ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë 15 pikë, ndërsa kandidati i rekomanduar është vlerësuar me 20 pikë, në këtë rast pretendimi i ankuesit është i pabazuar sepse vlerësimi për këtë pjesë është bërë në mënyrë të drejtë.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se testi me shkrim ka pasur pyetje për të hutuar në përgjigje për të më ve në lajthitje me gabime teknike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi nga testi me shkrim është vlerësuar me 51 pikë, ku testi me shkrim përmes sistemit elektronik dhe i njëjti është anonim për secilin kandidatë, dhe ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi që dëshmon se pretendimet ankimore të tij janë të bazuara.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se komisioni vlerësues ka ndërhyrë në poentimin tim, ka konstatuar se poentimi i të gjithë kandidatëve si në testim me shkrim po ashtu edhe në intervistën me gojë, bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Birimeve Njerëzore, dhe për këtë pretendim kemi kërkuar deklaratë me shkrim nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Sprovues të Kosovës i cili ka deklaruar me shkrim se: *“Komisioni vlerësuar lidhur me pyetjen konstaton se nuk ka pas asnjë mundësi të manipulimit të testit me shkrim e as me gojë. I tërë procesi me shkrim ka qenë në mbikëqyre të komisionit vlerësues dhe nuk ka pas ndonjë pengesë për mos vazhdimin e testit. Me përgjegjësi e themi se komisioni vlerësues në çdo fazë të vlerësimit ka pasur parasysh respektimin e plote të integritetit të secilit kandidat, kemi vlerësuar drejtë sipas meritave për secilin kandidat”,* në këtë rast pretendimi i ankuesit është i pa provuar, sepse ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshëm dhe po ashtu nga provat e organit të punësimit nuk kemi vërejtur një gjë të tillë.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që kandidati i pranuar para 7-8 vitesh ka pasur një incident shëndetësor në vendin e punës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, shqyrton procedurën e rekrutimit në këtë rast procedurën e ngritjes në detyre për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për Perona të Mitur, mbi bazë të kriterëve që janë përcaktuar në konkurs dhe legjislacionin në fuqi, në këtë rast kandidati i rekomanduar ka plotësuar të gjithë kriteret e përcaktuara për këtë pozitë, bazuar në këtë dhe konstatimet e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson që procesin i ngritjes në detyrë për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për Perona të Mitur në Shërbimin Sprovues të Kosovës është zhvilluar në pajtim me nenin 8 dhe 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe në pajtim me dispozitat nga neni 52 deri në neni 63 ndërlidhur me nenin 48 dhe 51 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Përgjigja në ankesë e datë 13.01.2022 nga Komisioni Vlerësues i Shërbimit Sprovues i Kosovës është nxjerr në pajtim, me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.50/2022, datë 02.03.2022

Avdyl BEKTESHI

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI  
  
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

